



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 1376 Prot.

Ersekë, më 15.02.2026

RAPORT PËRFUNDIMTAR
AUDITIM I KOMBINUAR
NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE PUBLIKE

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
II.	HYRJE.....	5
III.	METODA E AUDITIMIT	7
IV.	GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM	8
V.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË	47
	ANEKSI Nr.1	48
	ANEKSI Nr.2	49

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Nga struktura organizative e Bashkisë Kolonjë e miratuar për vitin 2024 dhe vitin 2025, rezulton se pranë kësaj Bashkie ka funksionuar Drejtoria e Shërbimeve Publike, e cila për nga struktura organizative për vitin 2024 ka funksionuar si drejtori me 6 sektorë, ndërsa gjatë vitit 2025 ka funksionuar si drejtori me 5 sektorë.
2. Në bazë dhe për zbatim të nenit 5, nenit 6 pika “b” ii), v) dhe vi), si dhe pikës 2 të Nenit 9 të Ligjit Nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” (*i ndryshuar*), “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Planit Vjetor të miratuar nga Titullari i Institucionit me Vendimin Nr. 36, datë 16.10.2024 për vitin 2025 si dhe Urdhërit të Shërbimit Nr. 6604 Prot., datë 18.11.2025 të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm, Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë, ushtroi auditimin në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
3. Objekti i Auditimit: Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Publike me aktet ligjore në fuqi dhe vlerësimi nëse përmbushja e objektivave të veprimtarisë në këtë drejtori po realizohet nëpërmjet proceseve efektive dhe përdorimit të fondeve me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.
4. Qëllimi i Auditimit: Të ndihmojë Drejtorinë e Shërbimeve Publike në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe menaxhimit të riskut.
5. Periudha e Auditimit: 01.01.2024-31.10.2025.
6. Përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve kryesore:
7. Gjatë ushtrimit të këtij auditimi, Njësia e Auditit të Brendshëm ka konstatuar një numër të konsiderueshëm parregullsish. Aspektet kryesore të këtyre parregullsive janë si më poshtë vijon:
 - Mungesë dokumentacioni për periudhën 2024-Maj 2025.
 - Mungon Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë.
8. **A. Sistemi për mirëmbajtjen**
 - Mungesa e dokumentacionit periodik.
 - Problematika në administrimin e materialeve dhe mbetjeve.
 - Mungesa e evidencave fotografike dhe kontrollit në terren.
 - Parregullsi në menaxhimin e mbetjeve.
9. **B. Sistemi për transportin dhe licensimet**
 - Mungesa e dokumentacionit teknik dhe historikut të mjeteve.
 - Parregullsi në administrimin e karburantit dhe fletë-udhëtimeve.
 - Mosdokumentimi i servisit dhe pjesëve të ndërruara.
 - Mungesa e mjeteve të sigurisë dhe higjienës.

10. **C. Sistemi për punët publike**

- Mungesa e planifikimit dhe analizave periodike.
- Parregullsi në administrimin e materialeve dhe magazinës.
- Mangësi në mbikëqyrjen teknike dhe dokumentacionin e projekteve.
- Probleme me monitorimin e firmave të pastrimit dhe mbetjeve.

11. **D. Sistemi i ndriçimit**

- Mungesa e dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së ndërhyrjeve.
- Mosdokumentimi i ankesave të qytetarëve.
- Mungesa e bazës materiale për rehabilitim.

12. **E. Sistemi i pastrim-gjelbërimit (Eco Kolonja)**

- Mungesa e grafikëve të detajuar dhe planit vjetor.
- Mungesa e pajisjeve (kazanëve) dhe moszbatimi i standardeve të vendosjes.
- Mangësi në monitorimin e firmave dhe kontrollin ditor.
- Mungesa e regjistrimit të aseteve të gjelbërimit.

13. **F. Sistemi i rrugëve rurale**

- Mungesa e planit të prioritizimit dhe inspektimit.
- Neglizhencë në sinjalistikën rrugore rurale.
- Mungesa e dokumentacionit teknik për zbatimin e projekteve.

14. **G. Sistemi i zhvillimit të komunitetit**

- Mungesa e raporteve analitike mbi nevojat e komunitetit.
- Mungesa e standardeve për personat me aftësi të kufizuara.
- Trajtimi i paformalizuar i ankesave për ndriçimin.

15. **H. Sistemi i burimeve njerëzore**

- Parregullësi në procedurat e dorëzimit të dokumentacionit, pas largimit nga detyra.
- Mospërputhja e detyrave reale me përshkrimet e punës.
- Mungesa e monitorimit të efektivitetit të burimeve.

16. **Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm**

Në përfundim të procesit të auditimit, Njësia e Auditit të Brendshëm konstaton se sistemet e kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë joefektive dhe paraqesin dobësi kritike që rrezikojnë arritjen e objektivave institucionale. Edhe pse në terren vërehet një angazhim operacional për kryerjen e punëve fizike, mungesa e një strukture rregullatore të brendshme dhe vakumi total dokumentar për periudha të caktuara dëshmojnë se kontrollet janë joefektive dhe jo parandaluese. Sistemi karakterizohet nga një mungesë totale dokumentacioni

ku vendimmarrja nuk bazohet në plane prioritizimi apo analiza nevojash, por në ndërhyrje sporadike, duke e lënë institucionin të ekspozuar ndaj risqeve të larta për shpërdorim të aseteve (karburant, materiale magazinë etj.), mungesë të transparencës financiare dhe rënie të cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Dobësitë në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe mungesa e monitorimit të kontratave me palë të treta (firmat e pastrimit) e bëjnë mjedisin e kontrollit të dobët, duke kërkuar një reformim të menjëhershëm përmes hartimit të rregulloreve, formalizimit të proceseve të raportimit dhe forcimit të llogaridhënies në të gjitha nivelet hierarkike.

II. HYRJE

17. Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, u realizua auditim i kombinuar që përfshiu sistemin për mirëmbajtjen, për transportin dhe licensimet, për punët publike, sistemin e ndriçimit, e pastrim-gjelbërimit (Eco Kolonja), e rrugëve rurale, e zhvillimit të komunitetit dhe sistemin e burimeve njerëzore.
18. Auditimi u krye bazuar në dispozitat ligjore të mëposhtme:
- -Ligjit Nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” (i ndryshuar);
 - -Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave;
 - -Urdhëri i Shërbimit Nr.6604 Prot., datë 18.11.2025 të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm;
 - Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbetjeve”;
 - Ligji nr. 10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar me ligjin nr. 31/2013 datë 14.2.2013;
 - VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” i ndryshuar me VKM nr. 579, datë 3.9.2014;
 - VKM nr. 175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”;
 - VKM Nr.798, datë 29.09.2010 për “Miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”;
 - VKM Nr. 177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”;
 - VKM Nr. 178, datë 06.03.2012 “Për incimin e mbetjeve”;
 - VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 “Për Lendfillet e mbetjeve”;
 - VKM Nr. 765, datë 7.11.2012 “Për Miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”;
 - VKM nr. 418, datë 25.6.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
 - VKM nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inëtë”;
 - UDHËZIMI i MZHU dhe i MM nr. 1738, datë 12.3.2015“Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vendepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbanë, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impiantëve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbanë”;
 - RREGULLORE Nr.1, datë 30.03.2007, “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre”;
 - Ligji nr.8378,date 22.07.1998 “Kodi Rrugor”,I ndryshuar
 - Ligji nr.8303,datë 18.03.1998,”Për transportet rrugore”,I ndryshuar
 - Udhëzimi nr.1649,datë 16.08.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor” , I ndyshuar.

19. Auditimi u krye në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit të miratuar nga Titullari i Institucionit me me Vendimin Nr. 36, datë 16.10.2024 për vitin 2025 si dhe Programit të Angazhim Auditimit Nr. 6738 Prot., datë 26.11.2025.
20. Për fillimin e misionit, grupi i auditimit kërkoi të zhvillohej takimin prezantues në ambientet e Bashkisë Kolonjë, takim i cili nuk u mbajt me subjektin, për shkaqe të pajustificuara. Grupi i auditimit, i komunikoi subjektit të audituar afatin për dorëzimin e dokumentacionit brenda datës 27.11.2025, afat ky që nuk u zbatua. Me Shkresën Nr. 6779 Prot., datë 27.11.2025, subjekti i audituar njoftoi arsyetimin për vonesën në dorëzimin e dokumentacionit të plotë objekt auditimi. Me Kërkesën Nr. 6972 Prot., datë 09.12.2025, NJAB i rikërkoi subjektit të audituar dorëzimin menjëherë të dokumentacionit të nevojshëm për auditim. Gjendur në kushtet kur subjekti i audituar nuk kishte dorëzuar asnjë lloj dokumentacioni në tejkallim të afateve të auditimit, NJAB kërkoi nga ana e Titullarit, shtyrej e afatit të auditimit deri më datën 06.02.2026. Kërkesë kjo që u miratua. Me Shkresën Nr.657 Prot., datë 26.01.2026, subjekti i audituar vuri në dispozicion të NJAB-së dokumentacion për periudhën Qershor-Tetor 2025, që përfshiu: dosje mujore me proces-verbale dhe urdhëra pune, dosje mujore me dokumentacion shoqërues dhe prova dokumentuese, raporte mujore për punët/ aktivitetet e kryera, listëprezencat mujore, kërkesa dhe shkresa për blerjen e materialeve të ndryshme, urdhëra për ngrohjen e institucioneve arsimore dhe urdhëra për ngritjen e komisioneve. Periudha 2024-maj 2025, nuk pati asnjë dokumentacion referues.
21. Misioni i auditimit u krye nga grupi i auditimit i përbërë nga:

Znj. Laura Skënderas - audituese, njëkohësisht përgjegjëse e grupit;
Z. Arnold Fetallari - auditues.
22. **Afati i auditimit:** Nga data 02.12.2025 deri më datën 06. 02.2026 me kërkesë për shtyrje afati të miratuar nga Titullari me Nr. 7400 Prot., datë 29.12.2025.
23. Titullari i Institucionit, u vu në djeni mbi ecurinë e angazhimit, problematikat e hasura, gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit.

III. METODA E AUDITIMIT

24. Në misionin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika si:

1. Rishikimi i dokumentacionit përmes verifikimit nëse Drejtoria e Shërbimeve Publike i zbaton ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse, shqyrtimi i regjistrave dhe dosjeve duke kontrolluar database, faturimet, akt-detyrimet, vërtetimet e shlyerjes së detyrimeve, licencat, formularët, planet e punës etj.

2. Intervistat me punonjësit për të marrë informacion mbi proceset dhe praktikat e ndjekura.

3. Testimi i mostrave (Sampling) duke zgjedhur dokumenta, urdhëra apo vendime dhe akte administrative të tjera për të vlerësuar përputhshmërinë ligjore.

U plotësuan pyetësorët për mjedisin e kontrollit të brendshëm, funksionimin organizativ të Drejtorisë Shërbimeve Publike etj.,.

Grupi i auditimit gjykoi se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për periudhën e audituar.

IV. GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM

25. Titulli i Gjetjes: Mungesë dokumentacioni për periudhën 2024-Maj 2025.

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 10296 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Megjithëse programi i auditimit përfshin periudhën Janar 2024 – Tetor 2025, për harkun kohor Janar 2024 – Maj 2025 nuk është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion (urdhra pune, raporte, fletë-udhëtimi, evidenca karburanti). Drejtori aktual ka deklaruar se nuk ka pasur procesverbal dorëzimi nga paraardhësi për këtë periudhë.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 10296 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"</p> <p>Ndikimi/Efekti: udituesi nuk mund të japë opinion mbi rregullshmërinë e shpenzimeve të karburantit, materialeve dhe pagave për 17 muaj.</p> <p>Shkaku: Moszbatimi i procedurave të dorëzimit të detyrës nga titullari paraardhës dhe mungesa e kontrollit nga strukturat eprorë të Bashkisë në momentin e ndryshimit të drejtuesve.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Auditimi konstaton një ndërprerje të gjurmueshmërisë administrative. Mungesa totale e dokumentacionit për periudhën 2024 - Maj 2025 e bën sistemin e shërbimeve publike të pauditueshëm për këtë kohë.
Rekomandimi	Të dorëzohet dokumentacioni i kërkuar për periudhën e mbetur.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.

Statusi i rekomandimit	Pranuar.
-------------------------------	----------

26. Titulli i Gjetjes: Mungon Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë.

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk disponon një rregullore të brendshme të miratuar që rregullon funksionimin specifik të sektorëve të saj (Pastrim, Ndriçim, Rrugë, etj.). Referimi bëhet vetëm në rregulloren e përgjithshme të Bashkisë, e cila nuk mbulon procedurat teknike, standardet e ndërhyrjes dhe zinxhirin e raportimit ditor.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".</p> <p>Ndikimi/Efekti: unonjësit veprojnë pa udhëzues teknikë zyrtarë, duke u bazuar në urdhra verbalë.</p> <p>Shkaku: Mungesa e vullnetit administrativ për të formalizuar proceset teknike dhe mbështetja e tepërt në praktikën e trashëguar (traditën) në vend të normës ligjore..</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	DSHP funksionon si një strukturë operative pa një "kokë" rregullatore. Pa një rregullore të brendshme, drejtoria e ka të pamundur të garantojë që 8 sistemet e saj (nga mirëmbajtja te burimet njerëzore) të funksionojnë në mënyrë uniforme, të ligjshme dhe të mbrojtura nga abuzimi..
Rekomandimi	Të hartohet dhe miratohet Rregullorja e Brendshme të Drejtorisë.

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

4.1 Sistemi për mirëmbajtjen

27. Titulli i Gjetjes: Mungesa e dokumentacionit periodik.

Nr. i Gjetjes 3	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Urdhrat e punës dhe raportet e veprimtarisë për periudhën Qershor-Tetor 2025 janë hartuar dhe protokolluar në Janar 2026, vetëm pas kërkesës së auditit.</p> <p>Kriteri: Standardet e Auditimit të Brendshëm dhe Rregullorja e Brendshme Kreu për DSHP që kërkon dokumentim në kohë reale të veprimtarisë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Dokumentacioni nuk pasqyron besueshmëri pasi është krijuar me vonesë. Mundësi për mospërputhje mes punës reale dhe asaj të raportuar.</p> <p>Shkaku: Mungesa e një sistemi ditor raportimi.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Drejtoria ka operuar pa dokumentacion formal gjatë periudhës së auditimit, duke e përpiluar atë në mënyrë retrospektive për të plotësuar kërkesat e auditit.
Rekomandimi	Të protokollohen urdhërat e punës para se të fillojë procesi i punës dhe të ndiqet raportimi ditor i tyre.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

28. **Titulli i Gjetjes:** Problematika në administrimin e materialeve dhe mbetjeve.

Nr. i Gjetjes 4	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Sipas regjistrit të riskut, ka mungesë të theksuar të mjeteve të punës (motokorsa), koshave të mbetjeve dhe vonesa në furnizim me materiale dezinfektuese (hipoklorit).</p> <p>Kriteri: Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ulje e cilësisë së shërbimit publik, mosrealizim i pastrimit ditor dhe rrezik për higjienën publike.</p> <p>Shkaku: Planifikim i dobët i kërkesave për bazë materiale dhe vonesa në procedurat e prokurimit/financës.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Drejtoria nuk ka kapacitetet e mjaftueshme materiale për të përmbushur detyrimet ligjore për mirëmbajtjen e territorit.
Rekomandimi	Të hartohet një plan vjetor i detajuar për nevojat materiale dhe të dërgohet për miratim në Drejtorinë e Financës brenda afateve buxhetore.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Para hartimit të projekt-buxhetit për vitin pasardhës.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

29. Titulli i Gjetjes: Mungesa e evidencave fotografike dhe kontrollit në terren.

Nr. i Gjetjes 5	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Në relacionin shpjegues pranohet se për ndërhyrjet e kryera (ndriçim, riparime rrugësh) nuk disponohen foto para dhe pas ndërhyrjes.</p> <p>Kriteri: Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Pamundësi për të vërtetuar nëse materialet e tërhequra nga magazina janë përdorur realisht në vendin e duhur. Rrezik abuzimi me bazën materiale.</p> <p>Shkaku: Moszbatimi i detyrës nga specialistët dhe mbikëqyrësit për dokumentimin vizual të punës.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Ka një mungesë transparence në ekzekutimin e punimeve të mirëmbajtjes, pasi mungon prova e kryerjes së punës.
Rekomandimi	Çdo raport përfundimtar pune duhet të shoqërohet me procesverbal dorëzimi dhe dosje fotografike (Para/Gjatë/Pas).
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

30. Titulli i Gjetjes: Parregullësi në menaxhimin e mbetjeve.

Nr. i Gjetjes 6	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 10 431 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Neni 143 i Rregullores së Brndshme, DSHP.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Mbetjet hidhen në mënyrë të parregullt dhe ka mungesë kontrollesh periodike në pikat e grumbullimit (Borovë/Bezhan).</p> <p>Kriteri: Ligji nr. 10 431 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Neni 143 i Rregullores së DSHP.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ndotje mjedisore, gjoha të mundshme nga inspektoriatet dhe rrezik për shëndetin publik.</p> <p>Shkaku: Mungesa e rojeve ose sistemit të monitorimit në eko-pika dhe mungesa e bashkëpunimit me sektorin e pastrimit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Procesi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nuk po kryhet sipas standardeve mjedisore të parashikuara në rregullore.
Rekomandimi	Të shtohet numri i kontrolleve periodike dhe të rrethohen/sistemohen pikat e grumbullimit për të parandaluar hedhjen jashtë tyre.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

31. *Sistemi i kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Shërbimeve Publike (DSHP) paraqitet me mangësi domethënëse për periudhën e audituar (Qershor – Tetor 2025). Megjithëse strukturat operative janë aktive në terren, proceset administrative që garantojnë transparencën dhe llogaridhënien janë të dobëta. Dokumentimi i veprimtarisë "post-factum" (muaj pas kryerjes së punës) tregon për një sistem jo-funksional të raportimit ditor dhe mungesë të mbikëqyrjes efektive në kohë reale.*

32. *Ekziston një mospërputhje mes objektivave të mirëmbajtjes dhe burimeve materiale në dispozicion. Mungesa e mjeteve bazë (motokorsa, kosha) dhe vonesat në furnizime tregojnë për një planifikim buxhetor jo-efektiv. Risku i lartë i identifikuar në regjistrin e drejtorisë nuk është shoqëruar me masa zbutëse konkrete gjatë periudhës së audituar, duke lënë hapësirë për abuzim me materialet (për shkak të mungesës së evidencave fotografike). Sistemi i mirëmbajtjes ofron një siguri të pamjaftueshme se objektivat po arrihen në mënyrë ekonomike, efektive dhe transparente. Drejtoria është mbështetur më shumë në ndërhyrje ad-hoc dhe emergjente sesa në një sistem të mirëfilltë mirëmbajtjeje të planifikuar dhe të dokumentuar.*

4.2 Sistemi për transportin dhe licensimet

33. Titulli i Gjetjes: Mungesa e dokumentacionit teknik dhe historikut të mjeteve.

Nr. i Gjetjes 7	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ekzistojnë procesverbale të kontrollit teknik ditor për periudhën Qershor-Tetor 2025. Raportimi i gjendjes teknike është bërë vetëm verbalisht dhe jo përmes raporteve të shkruara periodike.</p> <p>Kriteri: Neni 151 i Rregullores së Brendshme (Detyrat e shoferit).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Rrezik për defekte të rënda gjatë punës, rrezik për jetën e punonjësve dhe kosto të larta riparimi për shkak të mungesës së mirëmbajtjes parandaluese.</p> <p>Shkaku: Mungesa e formularëve standardë për kontrollin ditor dhe neglizhenca në zbatimin e rregullores nga sektori përkatës.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Kontrolli i mjeteve nuk kryhet në mënyrë të rregullt.
Rekomandimi	Të hartohet dhe të plotësohet lista e Kontrollit Teknik përpara nisjes së mjetit në punë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

34. Titulli i Gjetjes: Parregullsi në administrimin e karburantit dhe fletë-udhëtimeve.

Nr. i Gjetjes 8	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për periudhën e audituar, dokumentacioni i vetëm i dorëzuar janë blloqet e karburantit. Fletë-udhëtimet, nuk janë të shoqëruara me raporte pune që vërtetojnë kilometrazhin e kryer për çdo shërbim specifik.</p> <p>Kriteri: Neni 151 i Rregullores (Detyra e shoferit për dorëzimin e fletë-udhëtimeve të firmosura).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Pamundësi për të audituar konsumin real të karburantit kundrejt punës së kryer. Potencial për abuzim me karburantin e institucionit.</p> <p>Shkaku: Dobësi në kontrollin e brendshëm mbi lëvizjen e mjeteve dhe dorëzimi i dokumenteve pa verifikim paraprak.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Dorëzimi i fletë-udhëtimeve është thjesht një proces formal dhe nuk shërben si mjet kontrolli për eficientësinë e shpenzimeve.
Rekomandimi	Fletë-udhëtimet të mbahen sipas kriterëve ligjore, të përmbajnë itinerarin e detajuar, orët e punës dhe të konfirmohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës ku ka shërbyer mjeti.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

35. Titulli i Gjetjes: Mosdokumentimi i servisit dhe pjesëve të ndërruara.

Nr. i Gjetjes 9	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ka procesverbale për dorëzimin e pjesëve të vjetra në magazinë pas riparimeve të mjeteve (servisit), siç kërkohet në rregullore.</p> <p>Kriteri: Neni 151 i Rregullores: "...marrin pjesë në servisin e tij duke dorëzuar gjithmonë pranë magazinës pjesët e vjetra".</p> <p>Ndikimi/Efekti: Rritje e kostove të mirëmbajtjes dhe vështirësi në inventarizimin e mjeteve dhe pjesëve të këmbimit.</p> <p>Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit mes sektorit të transportit dhe magazinierit të institucionit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Nuk ndiqet cikli i plotë i dokumentimit të riparimeve, duke lënë vend për paqartësi në përdorimin e fondeve për pjesë këmbimi.
Rekomandimi	Të ndalohet pagesa e faturave të serviseve e pashoqëruar me procesverbalin e dorëzimit të pjesëve të vjetra në magazinë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

36. Titulli i Gjetjes: Mungesa e mjeteve të sigurisë dhe higjienës.

Nr. i Gjetjes 10	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ka dëshmi apo fatura që vërtetojnë furnizimin e rregullt me mjete pastrimi sanitar për automjetet (detergjentë, mjete dezinfektimi).</p> <p>Kriteri: Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Amortizim i parakohshëm i brendshëm i mjeteve dhe kushte jo të mira pune për shoferët dhe punëtorët që transportohen.</p> <p>Shkaku: Mungesa e planifikimit të bazës materiale për mirëmbajtjen e mjeteve.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I ulët.
Konkluzioni	Higjena e mjeteve lihet në dëshirën e shoferit dhe jo si një proces i organizuar nga drejtoria.
Rekomandimi	Të sigurohet baza materiale për pastrim dhe të monitorohet gjendja e pastërtisë së mjeteve gjatë kontrolleve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

37. *Sistemi i transportit aktualisht operon nën një rrezik të lartë financiar, ku mungesa e një strukture monitorimi e ka kthyer menaxhimin e flotës së mjeteve motorike në një kosto të paparashikueshme. Pa një sistem të mirëfilltë "log" (regjistri) për çdo mjet, institucioni e ka të pamundur të krijojë një historik të qartë të shpenzimeve, duke humbur gjurmueshmërinë mbi ndërhyrjet në riparime dhe konsumin real të karburantit. Kjo zbrazëti administrative, e shoqëruar me mungesën e procesverbaleve teknike që dokumentojnë gjendjen e mjeteve para dhe pas shërbimeve, jo vetëm që nxit inefficencën operacionale, por krijon edhe hapësira për abuzime, pasi çdo defekt apo furnizim mbetet i paverifikueshëm. Në këto kushte, amortizimi i mjeteve ndodh jashtë kontrollit, duke rënduar buxhetin me kosto emergjente që mund të shmangeshin përmes një kontrolli të rregullt dhe dokumentimit rigoroz të çdo kilometri të shërbimi teknik.*

4.3 Sistemi për punët publike

38. Titulli i Gjetjes: Mungesa e planifikimit dhe analizave periodike.

Nr. i Gjetjes 11	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për periudhën qershor-tetor 2025, nuk ekzistojnë plane mujore pune të hartuara paraprakisht. Raportet periodike dhe analizat janë përpiluar në janar 2026, pas kërkesës së auditit, duke i dhënë dokumentacionit karakter formalizues dhe jo drejtues.</p> <p>Kriteri: Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Punët publike janë kryer pa një strategji të qartë, duke u bazuar në emergjenca dhe jo në prioritete të planifikuara. Pamundësi për të matur performancën e stafit.</p> <p>Shkaku: Mungesa e një sistemi të brendshëm monitorimi dhe vonësa në konsolidimin e stafit administrativ.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Drejtoria ka dështuar në përmbushjen e ciklit të menaxhimit (Planifikim-Ekzekutim-Raportim) gjatë periudhës së audituar.
Rekomandimi	Të hartohet plani mujor i punës dhe analizat mujore të dokumentohen me procesvverbal mbledhjeje.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

39. Titulli i Gjetjes: Parregullsi në administrimin e materialeve dhe magazinës.

Nr. i Gjetjes 12	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ekziston një regjistër i rregullt i hyrje-daljeve të materialeve në magazinë për punët publike. Materialet (çakull, asfalt, pajisje ndriçimi) tërhiqen pa u shoqëruar gjithmonë me fletë-dalje që specifikojnë projektin apo vendndodhjen ku do përdoren.</p> <p>Kriteri: Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Rrezik i lartë për keqpërdorim të asetëve publike. Pamundësi për të llogaritur koston reale të rehabilitimit të një objekti apo rruge.</p> <p>Shkaku: Mungesa e koordinimit mes përgjegjësit të sektorit dhe magazinës.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Sistemi i kontrollit mbi lëvizjen e inventarit është i dobët, duke ekspozuar institucionin ndaj humbjeve financiare.
Rekomandimi	Të regjistrohet dhe dokumentohet çdo ndërhyrje publike, ku të shënohet sasia e materialit të përdorur, i konfirmuar me firmën e mbikëqyrësit të punimeve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

40. Titulli i Gjetjes: Mangësi në mbikëqyrjen teknike dhe dokumentacionin e projekteve.

Nr. i Gjetjes 13	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për investimet e vogla dhe punët rehabilituese (si mozaiku në qendër apo ndriçimi), mungon dokumentacioni teknik paraprak (skica, preventivë) dhe proces-verbalet e mbikëqyrjes gjatë procesit.</p> <p>Kriteri: Rregullorja e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Cilësi e pasigurt e punimeve dhe mungesë garancie për jetëgjatësinë e investimeve publike.</p> <p>Shkaku: Mungesa e emërimit të mbikëqyrësve specifikë për punët që kryhen nga punonjësit e DSHP.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Mbikëqyrja e punimeve publike është kryer në mënyrë sporadike dhe pa procesverbale konstatimi në terren.
Rekomandimi	Të merren masat për mbikëqyrjen teknike për çdo projekt rehabilitimi dhe të dokumentohet ecuria.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

41. Titulli i Gjetjes: Probleme me monitorimin e firmave të pastrimit dhe mbetjeve.

Nr. i Gjetjes 14	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbetjeve".
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Monitorimi i firmave të pastrimit nuk rezulton i dokumentuar me raporte kontrolli. Ndërkohë, mbetjet në pikat e grumbullimit (Borovë/Bezhan) hidhen në mënyrë të parregullt, duke shkelur rregulloret mjedisore.</p> <p>Kriteri: Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbetjeve".</p> <p>Ndikimi/Efekti: Penalizime nga institucionet qendrore (AKM/IMT) dhe degradim i infrastrukturës sanitare.</p> <p>Shkaku: Mungesa e mjeteve (koshave metalikë) siç pranohet në regjistrin e riskut dhe mungesa e rojeve në pikat e grumbullimit</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Funksioni i monitorimit dhe zbatimit të ligjit për mbetjet është jo-efektiv, duke u kthyer në një risk mjedisor për komunitetin.
Rekomandimi	Të hartohet një kalendar inspektimi për firmat e kontraktuara dhe të merren masat për rrethimin dhe sigurimin e eko-pikave.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6 mujorit të parë të 2026.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

42. *Sistemi i Punëve Publike në shfaq një shkëputje kritike midis intensitetit të punës në terren dhe dokumentimit administrativ, duke operuar në një mjedis ku mungesa e dokumentacionit të gjurmueshëm cënon rëndë integritetin e proceseve. Kjo theksohet veçanërisht nga fakti se investimet dhe ndërhyrjet kryhen pa një planifikim paraprak strategjik, duke e kthyer aktivitetin e drejtorisë në një proces reaktiv ndaj emergjencave, i cili është i pamundur të auditohet në terma të efikasitetit dhe performancës së stafit.*
43. *Mungesa e kontrollit rigoroz mbi magazinën dhe qarkullimin e materialeve si asfalte apo pajisje ndriçimi, krijon një rrezik të lartë për rrjedhje të aseteve publike, pasi pa procesverbale mbikëqyrjeje dhe fletë-dalje specifike për çdo projekt, kostoja reale e rehabilitimeve mbetet tërësisht e pajustificuar.*
44. *Më tej, neglizhenca në dokumentimin e mbikëqyrjes teknike dhe monitorimit të firmave të pastrimit jo vetëm që cenon cilësinë e investimeve dhe mbrojtjen e mjedisit, por e ekspozon institucionin ndaj sanksioneve ligjore dhe humbjeve financiare të konsiderueshme. Rrjedhimisht, sistemi aktual kërkon një reformim të thellë që integron regjistrat analitike, emërimet zyrtare të mbikëqyrësve dhe protokollet e rregullta të raportimit, me qëllim që të shndërrohet nga një strukturë që operon në kundërshtim me parashikimet ligjore në një model transparence që garanton llogaridhënien për fondet publike.*

4.4 Sistemi i ndriçimit

45. Titulli i Gjetjes: Mungesa e dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së ndërhyrjeve.

Nr. i Gjetjes 15	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Manuali i MFK.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për periudhën qershor-tetor 2025, nuk ekzistojnë proces-verbale teknike apo librezë e shërbimit të ndriçimit publik. Ndërhyrjet janë kryer, por dokumentimi i tyre është bërë në mënyrë retrospektive në janar 2026.</p> <p>Kriteri: Manuali i MFK.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Pamundësi për të vërtetuar garancinë e standardeve teknike dhe jetëgjatësinë e llambave apo materialeve elektrike të vendosura.</p> <p>Shkaku: Mungesa e një formati standard raportimi për elektrikistët.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Shërbimi i ndriçimit funksionon në mënyrë të pagjurmueshme duke e bërë të pamundur planifikimin e mirëmbajtjes parandaluese
Rekomandimi	Të krijohet Regjistri i Ndërhyrjeve në Ndriçim, ku të shënohet data, vendndodhja (shtyllat), materiali i përdorur dhe firma e elektrikistit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

46. **Titulli i Gjetjes:** Mosdokumentimi i ankesave të qytetarëve.

Nr. i Gjetjes 16	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Ndonëse elektrikistët kanë për detyrë zgjidhjen e ankesave të popullit (Neni 152 i Rregullores), nuk ka një regjistër ku të evidentohet koha e marrjes së ankesës dhe koha e reagimit/zgjidhjes.</p> <p>Kriteri: Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: : Ulje e besueshmërisë së qytetarëve tek shërbimet e Bashkisë dhe mungesë transparence në prioritizimin e ndërhyrjeve.</p> <p>Shkaku: Komunikimi i ankesave bëhet kryesisht në rrugë verbale ose përmes njësive administrative pa u protokolluar.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I ulët.
Konkluzioni	Procesi i zgjidhjes së ankesave është i paorganizuar administrativisht.
Rekomandimi	Të mbahen proces-verbale për zgjidhjen e rasteve të problematikave me ndriçimin.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

47. Titulli i Gjetjes: Mungesa e bazës materiale për rehabilitim.

Nr. i Gjetjes 17	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Regjistri i riskut tregon se ka vonesa në furnizimin me materiale elektrike. Kjo ka çuar në ndërhyrje vetëm në pikat më kritike, duke lënë zona të tëra me ndriçim të mangët gjatë periudhës së audituar.</p> <p>Kriteri: Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Cënim i sigurisë rrugore dhe sigurisë së qytetarëve gjatë natës në parqe e lulishte.</p> <p>Shkaku: Planifikimi i dobët i nevojave për bazë materiale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Rehabilitimi i ndriçimit është i kushtëzuar nga mungesa e stokut të materialeve rezervë.
Rekomandimi	Të bëhet një inventarizim i gjendjes së ndriçimit në të gjitha njësitë administrative dhe të paraqitet kërkesa për blerje të materialeve bazë për stok (llamba, dritë-përçues, siguresa).
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6 mujorit të parë 2026.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

48. *Edhe pse sistemi i ndriçimit publik në Bashkinë Kolonjë tregon një angazhim të lartë në terren, ku defektet riparohen dhe ndriçimi mbetet funksional, ky proces operon në mungesë të pasqyrimin në dokumentacion, gjë kjo që rrezikon llogaridhënien financiare. Problemi kryesor qëndron te mungesa e një regjistri të centralizuar për ankesat e qytetarëve dhe mungesa e procesverbaleve të kontrollit vizual, gjë që e bën të pamundur vërtetimin nëse një ndërhyrje ka qenë realisht e nevojshme apo nëse materialet elektrike të tërhequra nga magazina janë përdorur në sasinë e duhur. Pa një dokumentacion që lidh kërkesën fillestare me urdhërshpenzimin e materialeve (si llambat, telat apo automatet) procesi mbetet i paverifikueshëm.*

4.5 Sistemi i pastrim-gjelbërimit (Eco Kolonja)

49. Titulli i Gjetjes: Mungesa e grafikëve të detajuar dhe planit vjetor.

Nr. i Gjetjes 18	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> VKM Nr.418, datë 27.5.2020 PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE TË PLANIT KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE, 2020–2035.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Gjatë periudhës qershor-tetor 2025, nuk rezulton të jenë hartuar grafikë ditorë/mujorë të grumbullimit të mbetjeve apo një plan vjetor i miratuar. Dokumentacioni i paraqitur (raportet mujore) është krijuar retrospektivisht në janar 2026.</p> <p>Kriteri: VKM Nr.418, datë 27.5.2020 PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE TË PLANIT KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE, 2020–2035.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesë efëçence në përdorimin e mjeteve (karburant/orë pune) dhe rrezik për mbulim të pabarabartë të zonave urbane dhe rurale.</p> <p>Shkaku: Mungesa e një sistemi monitorimi në kohë reale dhe mosfunksionimi i hallkës së planifikimit administrativ brenda sektorit "Eco Kolonja".</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Sektori operon pa instrumente planifikimi, duke u bazuar në punën rutinë pa objektiva të matshëm.
Rekomandimi	Të hartohet grafiku ditor i lëvizjes së mjeteve të pastrimit për çdo lagje dhe njësi administrative, i cili duhet të afishohet dhe monitorohet çdo ditë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Çdo muaj.

Statusi i rekomandimit	Pranuar.
-------------------------------	----------

50. **Titulli i Gjetjes:** Mungesa e pajisjeve (kazanëve) dhe moszbatimi i standardeve të vendosjes.

Nr. i Gjetjes 19	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike • Drejtoria e Financës.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 10 431 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Regjistri i Riskut (Pika 10) identifikon si risk të lartë mungesën e koshave të mbetjeve. Si pasojë, mbetjet shpesh hidhen në mënyrë të parregullt në pika të paautorizuara.</p> <p>Kriteri: Ligji nr. 10 431 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ndotje e mjedisit, përhapje e aromave të pakëndshme dhe rritje e kostos së pastrimit manual për shkak të shpërndarjes së mbetjeve jashtë pikave të grumbullimit.</p> <p>Shkaku: Mosmiratimi i fondeve për blerjen e koshave metalikë (identifikuar si nevojë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës)</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Bashkia nuk plotëson kriteret minimale teknike për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë territorin për shkak të mungesës së infrastrukturës depozituese.
Rekomandimi	Të bëhet një inventarizim i nevojave për kosha në të gjithë Bashkinë dhe të sigurohet fondi emergjent për blerjen e koshave metalikë sipas specifikimeve teknike.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë 2026.

Statusi i rekomandimit	Pranuar.
-------------------------------	----------

51. **Titulli i Gjetjes:** Mangësi në monitorimin e firmave dhe kontrollin ditor.

Nr. i Gjetjes 20	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ka raporte periodike të kontrollit mbi punën e firmave të kontraktuara apo punonjësve të mirëmbajtjes (varrezat, lulishtet). Kontrolli ditor është bërë verbalisht pa procesverbale konstatimi.</p> <p>Kriteri: Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Pamundësi për të penalizuar firmat në rast të mosrespektimit të kontratës. Rrezik për kryerje të mangët të shërbimit në zonat periferike dhe varreza</p> <p>Shkaku: Mungesa e përgjegjësisë së inspektorëve të terrenit për të dokumentuar konstatimet ditore.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Mbikëqyrja e shërbimit të pastrimit është joformale, duke dobësuar mekanizmat e llogaridhënies ndaj kontraktorëve.
Rekomandimi	Të kryhen rregullisht kontrollet në terren, duke përcaktuar me grafik secilën zonë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.

Statusi i rekomandimit	Pranuar.
-------------------------------	----------

52. Titulli i Gjetjes: Mungesa e regjistrit të aseteve të gjelbërimit.

Nr. i Gjetjes 21	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ekziston një dokument/regjistër që evidenton drurët dekorativë dhe pemët sipas llojeve dhe vendndodhjes si dhe mungon plani i krasitjeve periodike.</p> <p>Kriteri: Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Krasitje jashtë kohës teknike që dëmtojnë pemët dhe vështirësi në planifikimin e blerjeve të reja për gjelbërim.</p> <p>Shkaku: Mungesa e specialistit agronom ose ekspertit të gjelbërimit në stafin e DSHP gjatë periudhës së audituar.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I ulët.
Konkluzioni	Gjelbërimi menaxhohet në mënyrë empirike pa pasur një inventar shkencor të pasurisë bimore të qytetit.
Rekomandimi	Të hartohet plani për gjelbërimin dhe krasitjen për zonën urbane, ku të specifikohen nevojat për ndërhyrje, krasitje dhe zëvendësime.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë 2026.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

53. *Sistemi "Eco Kolonja" paraqet mospërputhje midis përpjekjeve fizike në terren dhe strukturimit administrativ, ku mungesa e infrastrukturës bazë, siç janë kazanët e mbetjeve, e kthen shërbimin në një proces jo të plotë dhe tejet të vështirë për t'u menaxhuar. Edhe pse stafi tregon një angazhim të plotë në pastrimin e zonave specifike si varrezat apo pedonalet, ky aktivitet mbetet i pakoordinuar në mungesë të grafikëve zyrtarë të lëvizjes dhe raporteve të dokumentuara të monitorimit, duke e bërë të pamundur matjen e performancës apo argumentimin e shpenzimeve operacionale. Ky vakum planifikimi jo vetëm që e lë shërbimin të cenueshëm ndaj kritikave të drejtprejta të komunitetit për shkak të grumbullimit të mbetjeve jashtë pikave të caktuara, por krijon edhe një pengesë serioze për auditimin, pasi pa një itinerar të miratuar dhe pa proces-verbale kontrolli, është e vështirë të provohet efektiviteti i përdorimit të burimeve njerëzore dhe logjistike.*
54. *Rrjedhimisht, pa një ndërhyrje për të formalizuar çdo etapë të procesit, duke filluar nga vendosja e infrastrukturës e deri te dokumentimi i çdo rruge pastrimi, sistemi rrezikon të mbetet jo plotësisht efektiv dhe i pambrojtur përballë kërkesave për llogaridhënie dhe standarde mjedisore.*

4.6 Sistemi i rrugëve rurale

55. Titulli i Gjetjes: Mungesa e planit të prioritizimit dhe inspektimit.

Nr. i Gjetjes 22	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Standardet teknike të mirëmbajtjes së rrugëve.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ekziston një regjistër i inspektimit të rrugëve rurale që vërteton kontrollin e projekteve dhe sigurisë. Ndërhyrjet në zonat rurale (si ato në Bejkovë) janë kryer pa pasur një rend prioriteti të dokumentuar mbi gjendjen e të gjithë rrjetit rurale të Bashkisë.</p> <p>Kriteri: Standardet teknike të mirëmbajtjes së rrugëve.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Shpërndarje jo-efektive e burimeve (çakull, mjete të rënda). Rrezik që zona me problematika më emergjente të mbeten pa ndërhyrje për shkak të mungesës së evidencës.</p> <p>Shkaku: Mungesa e ekspertëve.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Evidentimi i problematikave është i fragmentuar dhe varet nga kërkesat e administratorëve të njëjësive, jo nga një inspektim teknik i pavarur.
Rekomandimi	Të hartohet një hartë e risqeve të infrastrukturës rurale ku të specifikohen segmentet që kërkojnë ndërhyrje emergjente, sezonale apo rikonstruksion total.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë 2026.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

56. Titulli i Gjetjes: Neglizhencë në sinjalistikën rrugore rurale.

Nr. i Gjetjes 23	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga verifikimet në dokumentacionin e punimeve, rezulton se ndërhyrjet janë fokusuar vetëm në shtrim/rulim me çakull, duke anashkaluar plotësisht verifikimin dhe vendosjen e sinjalistikës. Zonat rurale rezultojnë me sinjalistikë pothuajse ekzistente ose të dëmtuar.</p> <p>Kriteri: Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Pasiguri për qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve, veçanërisht në zonat me kthesa të rrezikshme apo pranë qendrave të banuara rurale.</p> <p>Shkaku: Fokusimi i drejtorisë vetëm tek punimet e infrastrukturës "së rëndë" dhe mungesa e një buxheti të dedikuar për tabelat dhe shenjat rrugore.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Bashkia nuk garanton standardet minimale të sigurisë rrugore në akset rurale nën administrimin e saj.
Rekomandimi	Të përfshihet në planin e investimeve blerja dhe vendosja e sinjalistikës vertikale për pikat më kritike të akseve rurale.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 2026.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

57. Titulli i Gjetjes: Mungesa e dokumentacionit teknik për zbatimin e projekteve.

Nr. i Gjetjes 24	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Rehabilitimi i rrugëve rurale (p.sh. hapje, shtrim me çakull) kryhet pa projekte teknike të thjeshtuara apo preventivë paraprakë. Nuk ka procesverbale që vërtetojnë trashësinë e shtresave të çakullit apo cilësinë e rulimit.</p> <p>Kriteri: Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Qëndrueshmëri e ulët e rrugëve (shpëlarje nga shirat e parë) dhe vështirësi në auditimin e sasive të materialeve (çakullit) të përdorura realisht</p> <p>Shkaku: Praktika e punimeve me "forca veta" pa mbikëqyrje teknike të dokumentuar.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Punimet në rrugët rurale kryhen në mënyrë empirike, duke rrezikuar efektivitetin e shpenzimeve publike.
Rekomandimi	Të mbahet një skicë-preventiv dhe një procesverbal përfundimtar të nënshkruar nga teknikët e fushës për çdo ndërhyrje në rrugë rurale.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

58. *Sistemi i menaxhimit të infrastrukturës rrugore, paraqet një rrezik kritik si në aspektin e sigurisë publike, ashtu edhe në atë të transparencës së përdorimit të fondeve, pasi operon në mungesë të standardeve teknike dhe dokumentacionit mbështetës. Ndonëse Drejtoria e Shërbimeve Publike ka treguar gatishmëri operative për ndërhyrje fizike dhe riparime emergjente, këto veprime mbeten sipërfaqësore dhe të pambrojtura nga ana ligjore, pasi mungesa e sinjalistikës paralajmëruese gjatë punimeve dhe mungesa e projekteve teknike (preventivave dhe skicave) e bëjnë pothuajse të pamundur auditimin e vëllimit real të materialeve të përdorura.*
59. *Ky vakum dokumentar krijon një paqartësi mbi cilësinë e punimeve dhe jetëgjatësinë e tyre, duke e shndërruar mirëmbajtjen në një kosto të përsëritur e të lartë në afatgjatë, ku investimet mund të shpërdorohen për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe specifikimeve teknike. Pa një sistem rigoroz që regjistron çdo metër katror asfalt të shtruar apo çdo mjet sinjalizues të vendosur, institucioni mbetet i ekspozuar ndaj përgjegjësisë civile në rast aksidentesh dhe ndaj dyshimeve për menaxhim joefikas të burimeve publike, duke e bërë të domosdoshme kalimin nga ndërhyrjet me hamendësim drejt një procesi të mirëfilltë inxhinierik të dokumentuar.*

4.7 Sistemi i zhvillimit të komunitetit

60. Titulli i Gjetjes: Mungesa e raporteve analitike mbi nevojat e komunitetit.

Nr. i Gjetjes 25	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Standardet e qeverisjes vendore për gjithëpërfshirjen.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ekzistojnë raporte periodike apo analiza socio-ekonomike që pasqyrojnë nevojat reale të komunitetit (pika 7.1). Dokumentacioni i vetëm i disponueshëm janë raporte pune operationale, por jo analiza që shërbejnë për zhvillimin e komunitetit.</p> <p>Kriteri: Standardet e qeverisjes vendore për gjithëpërfshirjen.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Politikat e zhvillimit të Bashkisë hartohen pa u bazuar në të dhëna konkrete nga terreni, duke rrezikuar investime që nuk përkojnë me kërkesat prioritare të banorëve.</p> <p>Shkaku: Mungesa e një sektori apo personi të dedikuar për ndërlidhjen me komunitetin brenda DSHP-së.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Bashkia operon në mënyrë reaktive (zgjdh probleme kur shfaqen) dhe jo proaktive (analizon dhe parashikon nevojat e komunitetit).
Rekomandimi	Të hartohet një pyetësor vjetor ose të organizohen dëgjesa publike të dokumentuara për të mbledhur problematikat kryesore të çdo lagje/fshati.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Gjatë vitit 2026.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

61. Titulli i Gjetjes: Mungesa e standardeve për personat me aftësi të kufizuara.

Nr. i Gjetjes 26	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Gjatë punimeve të rehabilitimit të rrugëve, objekteve apo zonave pedonale, nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë specifike për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (rampa, sinjalistikë zanore).</p> <p>Kriteri: Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Përrjashtim i një kategorie të komunitetit nga përdorimi i hapësirave publike dhe shkelje e standardeve kombëtare të ndërtimit.</p> <p>Shkaku: Mungesa e specifikimeve teknike në urdhrat e punës për zbatimin e standardeve të aksesueshmërisë.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Përmirësimi i shërbimeve publike nuk po bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke lënë pas dore nevojat e grupeve vulnerabël.
Rekomandimi	Çdo projekt rehabilitimi apo ndërtimi (trotuare, hyrje institucionesh) duhet të certifikohet nga tekniku i DSHP-së për respektimin e rampave dhe standardeve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

62. Titulli i Gjetjes: Trajtimi i paformalizuar i ankesave për ndriçimin.

Nr. i Gjetjes 27	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Zgjidhja e ankesave për ndriçimin bëhet rast pas rasti, por pa një sistem gjurmueshmërie. Nuk ka të dhëna se sa përqind e ankesave janë zgjidhur brenda afateve dhe sa kanë mbetur pezull</p> <p>Kriteri: Rregullore e Brendshme, Bashkia Kolonjë..</p> <p>Ndikimi/Efekti: Pakënaqësi e komunitetit dhe mungesë llogaridhënieje e stafit teknik ndaj qytetarëve.</p> <p>Shkaku: Mungesa e një linje apo platforme zyrtare (log-book) për regjistrimin e ankesave specifike për shërbimet publike.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I ulët.
Konkluzioni	Komunikimi me qytetarët është i fragmentuar dhe jo i dokumentuar, çka e bën të vështirë matjen e kënaqësisë së komunitetit.
Rekomandimi	Të krijohet një regjistër ankesash (fizik ose elektronik) ku të shënohet: Data e ankesës, Emri/ Adresa, Problematika, Data e zgjidhjes dhe Firma e qytetarit/ inspektorit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

63. *Sistemi i marrëdhënieve me komunitetin dhe analizës së nevojave publike përbën aktualisht hallkën më të dobët administrative të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, duke krijuar një hendek të rrezikshëm midis punës fizike në terren dhe misionit social të institucionit. Përqendrimi ekskluziv të ndërhyrjet mekanike, si pastrimi apo ndriçimi, pa u mbështetur në një sistem të dokumentuar të ankesave dhe sugjerimeve, e kthen investimin publik në një proces të njëanshëm që shpesh dështon të adresojë prioritetet reale të qytetarëve apo nevojat specifike për aksesueshmëri të grupeve të vulnerueshme.*

64. *Mungesa e raporteve periodike mbi kënaqshmërinë e komunitetit dhe mungesa e një baze të dhënash që monitoron impaktin e këtyre shërbimeve, e bën zhvillimin urban të duket i paorganizuar dhe tërësisht të pamatshëm në terma suksesi. Në këto kushte, pa një mekanizëm formal që integron zërin e qytetarit në planifikimin buxhetor dhe pa standarde të qarta për gjithëpërfshirjen në projektet publike, institucioni rrezikon të humbasë besimin e publikut dhe të operojë me inefficencë, duke kryer punime që mund të mos jenë prioritare, ndërkohë që kërkesat jetike të banorëve mbeten të paevidentuara dhe të paplotësuara.*

4.8 Sistemi i burimeve njerëzore

65. Evidencat për prezencën në punë për periudhën Qershor- Tetor 2025, janë dorëzuar të rregullta.
66. Titulli i Gjetjes: Parregullsi në procedurat e dorëzimit të dokumentacionit, pas largimit nga detyra.

Nr. i Gjetjes 28	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Drejtori i ri i DSHP ka marrë detyrën në Qershor 2025 pa një procesverbal dorëzimi nga paraardhësi. Nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion (plane, raporte, dosje teknike), përveç bllokut të karburantit.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" he Urdhri i Kryetarit Nr. 201, datë 27.05.2025, që kërkonte dorëzimin e plotë të dokumentacionit dhe inventarit.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesë vazhdimësie në punë si dhe vështirësi në monitorimin e punimeve të kaluara.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca e titullarit paraardhës dhe mungesa e kontrollit nga eprorët për zbatimin e urdhrit të dorëzimit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Procedura e marrjes së detyrës është kryer në kundërshtim me ligjin për arkivat dhe urdhrat e brendshëm, duke lënë institucionin pa prova dokumentuese për gjysmën e parë të vitit 2025 dhe gjithë vitin 2024.
Rekomandimi	Të hartohet një proces-verbal konstatimi për mungesat dhe të kërkohet përgjegjësi administrative për moszbatimin e Urdhrit Nr. 201, datë 27.05.2025.
Afati i fundit për zbatimin e	Menjëherë.

rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

67. Titulli i Gjetjes: Mospërputhja e detyrave reale me përshkrimet e punës.

Nr. i Gjetjes 29	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike. • Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Gjatë auditimit është konstatuar se përshkrimet e punës (pika 8.1) janë të përgjithshme dhe nuk pasqyrojnë detyrat specifike që punonjësit kryejnë në terren. Për më tepër, për shkak të mungesës së personelit, punonjësit shpesh kryejnë detyra që nuk i përkasin pozicionit të tyre (p.sh. punëtorët e pastrimit bëjnë edhe punë mirëmbajtjeje pa urdhër specifik)</p> <p>Kriteri: Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Paqartësi në llogaridhënie në rast gabimesh apo aksidentesh në punë. Pamundësi për vlerësim objektiv të performancës.</p> <p>Shkaku: Mungesa e rishikimit periodik të përshkrimeve të punës dhe nevoja për të mbuluar vakancat me stafin ekzistues.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Zbatimi i detyrave sipas pozicionit është i deformuar, duke cënuar strukturën formale të drejtorisë.
Rekomandimi	Të përditësohen përshkrimet e punës për çdo pozicion, duke specifikuar detyrat teknike dhe linjat e raportimit.

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

68. **Titulli i Gjetjes:** Mungesa e monitorimit të efektivitetit të burimeve.

Nr. i Gjetjes 30	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Shërbimeve Publike
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk ekzistojnë dëshmi të vlerësimit të efektivitetit të përdorimit të burimeve njerëzore. Nuk ka raporte që matin raportin mes orëve të punës dhe vëllimit të punimeve të realizuara (p.sh. sa m² rrugë janë pastruar për person)</p> <p>Kriteri: Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Shpërdorim i kohës së punës dhe pamundësi për të identifikuar nevojat për trajnim apo shpërblim të performancës.</p> <p>Shkaku: Mungesa e indikatorëve të performancës dhe mungesa e regjistrave të prezencës në terren të detajuar.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Menaxhimi i personelit bëhet në mënyrë sasiore (prezencë) dhe jo cilësore (efektivitet).
Rekomandimi	Të futet sistemi i raportimit ditor të punës për çdo grup terreni, ku të specifikohet objektivi i arritur kundrejt orëve të punës.

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Pranuar.

Opinion i përgjithshëm:

69. *Sistemi i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimeve Publike (DSHP), përbën një nga shkaqet e mungesës së dokumentacionit, që ka përfshirë sektorët e tjerë, pasi mungesa e personelit kyç administrativ ka krijuar një mbingarkesë ku stafi teknik detyrohet të mbulojë detyra që nuk janë në kompetencën e tyre. Edhe pse vullneti i punonjësve në terren është i lartë, ky angazhim mbetet i paorientuar për shkak të mungesës së përshkrimeve të qarta të punës, gje kjo që bën që përgjegjësitë të mbivendosen dhe llogaridhënia të mbetet e turbullt.*
70. *Pa një sistem formal të vlerësimit të performancës dhe pa indikatorë të qartë matës për efektivitetin e çdo punonjësi, drejtoria e ka të pamundur të identifikojë nevojat për trajnim apo të korrigojë inefficencat operationale, duke u mjaftuar me një menaxhim reaktiv që bazohet në instinkt dhe jo në të dhëna. Ky vakum strukturor jo vetëm që rrit riskun e performancës së ulët, por dekurajon stafin profesional dhe e lë institucionin të pambrojtur ndaj luhatjeve të cilësisë së shërbimit, duke e bërë urgjente hartimin e një ndarjeje funksionale ku çdo detyrë teknike shoqërohet me përgjegjësinë përkatëse dokumentare.*

4 ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË


71. Gjatë procesit të auditimit të kryer në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, u konstatua se nuk ka dokumentacion të disponueshëm pranë Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) që të mundësojë verifikimin e periudhës së fundit të mbuluar me auditim për këtë drejtori, si dhe të gjetjeve apo rekomandimeve që mund të jenë lënë nga auditimet e mëparshme. Mungesa e dokumentacionit referues për auditimet e kaluara tregon për një boshllëk në sistemin e ruajtjes dhe administrimit të evidencave të auditimit.
72. Në mungesë të dokumentacionit përkatës, nuk është e mundur të përcaktohet periudha e fundit kur kjo drejtori është përfshirë në ciklin e auditimeve të brendshme, natyra dhe rëndësia e gjetjeve të identifikuara më parë, niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe masat e ndërmarra nga drejtorja për përmirësim.
73. Mungesa e evidencave dokumentare, çënon parimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë, duke krijuar vështirësi në matjen e efektivitetit të auditimeve të mëparshme dhe në garantimin e një procesi të vazhdueshëm përmirësimi të veprimtarisë të subjekteve të audituara.
74. Në vijim, NjAB-ja do të marrë masa konkrete për të siguruar ndjekjen dhe monitorimin e rekomandimeve të lëna nga ky auditim. Do të hartohet një plan veprimi me afate dhe përgjegjësi të qarta për çdo rekomandim, si dhe do të kryhet ndjekja periodike e zbatimit të tyre përmes komunikimeve të vijueshme me subjektin e audituar.
75. Raporti i Auditimit hartohet në 4 (katër) kopje.

Grupi i Auditimit

Laura Skënderas



Arnold Fetallari



PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr.	REKOMANDIMI	NIVELI I RISKUT
1.	Të dorëzohet dokumentacioni i kërkuar për periudhën e mbetur.	I lartë.
2.	Të hartohet dhe miratohet Rregullorja e Brendshme të Drejtorisë.	I lartë.
3.	Të protokollohen urdhërat e punës para se të fillojë procesi i punës dhe të ndiqet raportimi ditor i tyre.	I mesëm.
4.	Të hartohet një plan vjetor i detajuar për nevojat materiale dhe të dërgohet për miratim në Drejtorinë e Financës brenda afateve buxhetore.	I lartë.
5.	Çdo raport përfundimtar pune duhet të shoqërohet me procesverbal dorëzimi dhe dosje fotografike (Para/Gjatë/Pas).	I mesëm.
6.	Të shtohet numri i kontrolleve periodike dhe të rrethohen/sistemohen pikat e grumbullimit për të parandaluar hedhjen jashtë tyre.	I lartë.
7.	Të hartohet dhe të plotësohet lista e Kontrollit Teknik përpara nisjes së mjetit në punë.	I mesëm.
8.	Fletë-udhëtimet të mbahen sipas kriterëve ligjore, të përmbajnë itinerarin e detajuar, orët e punës dhe të konfirmohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës ku ka shërbyer mjeti.	I lartë.
9.	Të ndalohet pagesa e faturave të serviseve e pashoqëruar me procesverbalin e dorëzimit të pjesëve të vjetra në magazinë.	I mesëm.
10.	Të sigurohet baza materiale për pastrim dhe të monitorohet gjendja e pastërtisë së mjeteve gjatë kontrolleve.	I ulët.
11.	Të hartohet plani mujor i punës dhe analizat mujore të dokumentohen me procesverbal mbledhjeje.	I mesëm.
12.	Të regjistrohet dhe dokumentohet çdo ndërhyrje publike, ku të shënohet sasia e materialit të përdorur, i konfirmuar me firmën e mbikëqyrësit të punimeve.	I lartë.
13.	Të merren masat për mbikëqyrjen teknike për çdo projekt rehabilitimi dhe të dokumentohet ecuria.	I mesëm.
14.	Të hartohet një kalendar inspektimi për firmat e kontraktuara dhe të merren masat për rrethimin dhe sigurimin e eko-pikave.	I lartë.
15.	Të krijohet Regjistri i Ndërhyrjeve në Ndriçim, ku të shënohet data, vendndodhja (shtyllat), materiali i përdorur dhe firma e elektrikistit.	I mesëm.
16.	Të mbahen proces-verbale për zgjidhjen e rasteve të problematikave me ndriçimin.	I ulët.
17.	Të bëhet një inventarizim i gjendjes së ndriçimit në të gjitha njësitë administrative dhe të paraqitet kërkesa për blerje të materialeve bazë për stok (llamba, dritë-përçues, siguresa).	I lartë.
18.	Të hartohet grafiku ditor i lëvizjes së mjeteve të pastrimit për	I mesëm.

	çdo lagje dhe njësi administrative, i cili duhet të afishohet dhe monitorohet çdo ditë.	
19.	Të bëhet një inventarizim i nevojave për kosha në të gjithë Bashkinë dhe të sigurohet fondi emergjent për blerjen e koshave metalikë sipas specifikimeve teknike.	I lartë.
20.	Të kryhen rregullisht kontrollet në terren, duke përcaktuar me grafik secilën zonë.	I mesëm.
21.	Të hartohet plani për gjelbërimin dhe krasitjen për zonën urbane, ku të specifikohen nevojat për ndërhyrje, krasitje dhe zëvendësime.	I ulët.
22.	Të hartohet një hartë e risqeve të infrastrukturës rurale ku të specifikohen segmentet që kërkojnë ndërhyrje emergjente, sezonale apo rikonstruksion total.	I mesëm.
23.	Të përfshihet në planin e investimeve blerja dhe vendosja e sinjalistikës vertikale për pikat më kritike të akseve rurale.	I lartë.
24.	Të mbahet një skicë-preventiv dhe një procesverbal përfundimtar të nënshkruar nga teknikët e fushës për çdo ndërhyrje në rrugë rurale.	I mesëm.
25.	Të hartohet një pyetësor vjetor ose të organizohen dëgjesa publike të dokumentuara për të mbledhur problematikat kryesore të çdo lagje/fshati.	I mesëm.
26.	Çdo projekt rehabilitimi apo ndërtimi (trotuare, hyrje institucionesh) duhet të certifikohet nga teknikë i DSHP-së për respektimin e rampave dhe standardeve.	I lartë.
27.	Të krijohet një regjistër ankesash (fizik ose elektronik) ku të shënohet: Data e ankesës, Emri/ Adresa, Problematika, Data e zgjidhjes dhe Firma e qytetarit/ inspektorit.	I ulët.
28.	Të hartohet një proces-verbal konstatimi për mungesat dhe të kërkohet përgjegjësi administrative për moszbatimin e Urdhrit Nr. 201, datë 27.05.2025.	I lartë.
29.	Të përditësohen përshkrimet e punës për çdo pozicion, duke specifikuar detyrat teknike dhe linjat e raportimit.	I mesëm.
30.	Të futet sistemi i raportimit ditor të punës për çdo grup terreni, ku të specifikohet objektivi i arritur kundrejt orëve të punës.	I mesëm.

Grupi i Auditimit

Laura Skënderas

Arnold Fetallari

OBSERVACIONET

Me shkresën përcjellëse Nr. 933 Prot., datë 06.02.2026, Njesisë së Audituar i është komunikuar zyrtarisht Projekt-Raporti. Bashkë me këtë raport, Njesisë i është bërë me dije edhe afati prej 10 (dhjetë) ditësh brenda të cilit ajo kishte të drejtë të paraqiste me shkrim vërejtje, komente apo observacione në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në dokument. Ky afat gjithashtu u ofronte mundësinë që, në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje apo sqarimi të mëtejshëm, të kërkohej një takim me titullarin e Institucionit për diskutim të drejtpërdrejtë mbi çështjet e ngritura në raport.

Në përfundim të këtij afati dhjetë ditor; rezulton se nga ana e Njesisë së Audituar nuk është dorëzuar asnjë dokument zyrtar që të përmbajë observacione apo kundërshtime lidhur me përmbajtjen e raportit. Gjithashtu, nuk është shprehur as kërkesë për zhvillimin e një takimi me drejtuesin e Institucionit. Në mungesë të ndonjë reagimi brenda afatit të caktuar, nënkuptohet se Njësia e Audituar i ka pranuar në mënyrë të plotë dhe pa kundërshtime të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e përcaktuara në Projekt-Raportin e Auditimit.

Grupi i Auditimit**Laura Skënderas****Arnold Fetallari**